



trainkos

HEKURUDHAT E KOSOVËS

RREGULLORJA PËR MBROJTJE NË PUNË

Fushë Kosovë

Maj 2015

Në bazë të Nenit 20 të Ligjit 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 26.23 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Koorporative për NP dhe në bazë të Ligjit nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, Bordi i Drejtorëve i Hekurudhave të Kosovës - Trainkos Sh.A në Mbledhjen nr. 54, të mbajtur më 19 dhe më 25.05.2015, miraton këtë:

RREGULLORE PËR MBROJTJE NË PUNË

KREU I DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i masave për përmirësimin e shkallës së sigurisë dhe shëndetit të punëtorëve të Trainkos Sh.A. parandalimi i rreziqeve profesionale, eliminimi i faktorëve të rrezikut dhe aksidenteve, informimit, konsultimit, pjesëmarrjes së balancuar në përmirësimin e nivelit të sigurisë dhe shëndetit në punë, trajnimit të punëtorëve, përfaqësuesve të tyre dhe udhëzimeve të përgjithshme për zbatimin e këtyre parimeve.

Neni 2 Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj rregulloreje, zbatohen për punëtorët e Trainkos Sh.A. përkatësisht në ato Departamente, Sektorë dhe njësi ku profesioni i cili ushtrohet duhet ti nënshtrohet mbrojtjes në punë. Siguria në punë, mbrojtja e shëndetit të punëtorëve dhe të ambientit të punës është pjesë integrale e organizimit të punës dhe e procesit të punës. Ajo duhet të vihet në funksion përmes aktivitetit të Trainkos Sh.A. dhe punëtorëve të saj të cilët iu përmbahen masave të nevojshme për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Neni 3 Përkufizimet

Punëdhënësi – personi fizik apo juridik i cili siguron punë për një ose më shumë të punësuar, i paguan pagën të punësuarit/ve për punën ose shërbimet e kryera dhe është përgjegjës për subjektin punues;

I punësuari - personi fizik i cili kryen punë ose shërbime me pagesë për punëdhënësin dhe ka marrëdhënie punësimi me punëdhënësin;

Siguria dhe shëndeti në punë – pjesë përbërëse e organizimit të procesit të punës, duke ndërmarrë masat parandaluese, që kanë synim përmirësimin e kushteve të punës, mbrojtjen e shëndetit të punëtorëve, përmirësimin e ambientit të punës, mbrojtjen fizike dhe psikike të punësuarve dhe të tjerëve që marrin pjesë në procesin e punës;

Rrezik (rreziqet profesionale) – mundësia që të punësuarit t'i shkaktohet plagë, sëmundje ose probleme shëndetësor të menjëhershme apo të mëvonshme, si rezultat i ekspozimit në ambientin e punës ku paraqiten elemente të dëmshme kimike, fizike dhe biologjike, mjeteve të punës dhe makinerive pa pajisje mbrojtëse dhe të pasigurta për përdorim, mënyrës së gabuar të përdorimit të mjeteve të punës dhe makinerive si dhe mënyrës së gabuar të organizimit të punës;

Sëmundje profesionale - çdo sëmundje e shkaktuar nga ekspozimi në elementet e dëmshme dhe të rrezikshme kimike, fizike dhe biologjike në ambientin e punës gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës;

Masat parandaluese - të gjitha veprimet e ndërmarra dhe të planifikuara në të gjitha proceset e punës në subjektin punues për të evituar dhe minimizuar rreziqeve që shkaktohen nga ushtrimi i veprimtarisë së punës;

Vendet e punës - përfshijnë të gjitha vendet dhe hapësirat nën mbikëqyrjen direkte dhe indirekte nga punëdhënësit ku të punësuarit duhet të kryejnë aktivitete pune dhe të qëndrojnë gjatë procesit të punës;

Personi i ngarkuar për sigurinë dhe shëndetin në punë - profesionist i cili është i punësuar te punëdhënësi dhe është i caktuar për të kryer detyra që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë;

Aksident në punë ose për shkak të punës - çdo ngjarje të papritur gjatë procesit të punës, që shkaktin dëmtimin të menjëhershëm trupor të të punësuarit/ve, dëmtim që sjell paaftësi të përkohshme, paaftësi të përhershme ose që sjell vdekje, si dhe çdo dëmtim tjetër të shëndetit që lidhet drejtpërdrejt me ushtrimin e veprimtarisë së punës;

Inspektorati i Punës – trup ekzekutiv i MPMS që mbikëqyr zbatimin e legjislacionit të punës, përfshirë edhe këtë ligj.

Ministria - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

KREU II DETYRIMET E TRAINKOS SH.A

Neni 4

Parimet e përgjithshme për Trainkos Sh.A.

1. Trainkos Sh.A. është përgjegjës për të krijuar kushtet e punës të sigurta dhe të shëndetshme.
2. Trainkos Sh.A. është e detyruar që të mbulojë të gjitha shpenzimet për kurimin e punëtorit që ka pësuar lëndim në punë apo sëmundje profesionale, nëse nuk i ka siguruar në ndonjë kompani të sigurimeve punëtorët në pikëpamje shëndetësore.
3. Trainkos Sh.A. është e detyruar që të bëjë vlerësimin e hollësishëm mbi rreziqet për secilin vend të punës.
4. Trainkos Sh.A. është e detyruar të udhëhiqet nga parimi i trajtimit të barabartë në marrjen e masave të sigurisë dhe shëndetit në punë për të gjithë punëtorët.

Neni 5

Detyrimet e përgjithshme të Trainkos Sh.A.

1. Trainkos Sh.A. detyrohet të ndërmarrë masat për siguri dhe shëndet në punë, përfshirë masat për parandalimin e rreziqeve profesionale, sigurimin e informatave, trajnimeve të punëtorëve për punë të sigurt, udhëzimet e duhura për përdorimin dhe mirëmbajtjen e makinerive, pajisjeve dhe veglave të punës, masat për organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit të punës.
2. Trainkos Sh.A. duhet të veprojë në vazhdimësi në përmirësimin e kushteve të punës për të ngritur nivelin e sigurisë dhe shëndetit në punë
3. Trainkos Sh.A. i përgjigjet punëtorit për dëmet e shkaktuara nga lëndimi në punë, sëmundjet profesionale ose sëmundjet e lidhura me punën.

Neni 6

Masat parandaluese

1. Trainkos Sh.A. detyrohet të zbatojë masat parandaluese, bazuar në parimet e përgjithshme për:
 - 1.1. Shmangien e rreziqeve;
 - 1.2. Vlerësimin e rreziqeve të pashmangshme;
 - 1.3. Luftimin e rrezikut prej fillimit ose burimit;
 - 1.4. Tejkalimin e shkaqeve të rrezikut;
-

- 1.5. Adaptimin e punës ndaj individit, veçmas në lidhje me karakteristikat e vendit të punës dhe ambientit të punës;
 - 1.6. Zgjedhjen e pajisjeve, metodave të punës dhe të procesit të punës, për të lehtësuar punën e njëtrajtshme, monotone dhe për t'i reduktuar efektet e saj në shëndet;
 - 1.7. Përshtatjen me progresin teknik;
 - 1.8. Zëvendësimin e kushteve të rrezikshme, me kushte të pa rrezikshme ose më pak të rrezikshme;
 - 1.9. Zhvillimin e një politike parandaluese gjithëpërfshirëse që ka të bëjë me teknologjinë, organizimin e punës, kushtet e punës, marrëdhëniet shoqërore dhe ndikimin e faktorëve që lidhen me dhënien e përparësisë së sigurisë kolektive në raport me sigurinë individuale;
 - 1.10. Sigurimin e udhëzimeve të përshtatshme për punë të sigurt dhe të shëndetshme, për të punësuarit dhe vendosjen e tyre në vendet e dukshme dhe në gjuhën që e kupton ai/ajo.
2. Trainkos Sh.A. duke marrë parasysh natyrën e aktiviteteve të subjektit punues, bën vlerësimin e rrezikshmërisë të vendeve të punës, substancave ose preparateve kimike që përdoren.
 3. Trainkos Sh.A. pas vlerësimit të bërë nga paragrafi 2. i këtij neni, nëse është e domosdoshme, duhet të:
 - 3.1. Sigurojë një nivel më të mirë të sigurisë dhe shëndetit në punë për të punësuarit duke eliminuar faktorët e rrezikut, zvogëluar ndikimin e substancave të dëmshme kimike, përmirësuar pajisjet e punës dhe duke larguar shprehitë e këqija në veprim gjatë procesit të punës;
 - 3.2. Integrojë dhe zbatojë masat parandaluese që dalin prej vlerësimit të rrezikut në të gjitha aktivitetet e subjektit punues dhe në të gjitha nivelet e hierarkisë;
 4. Trainkos Sh.A. kur ia beson detyrat e punës një të punësuarit, detyrohet të marrë parasysh aftësitë e tij/saj për kryerjen e atyre detyrave të punës;
 5. Trainkos Sh.A. detyrohet t'i informojë dhe trajnojë të punësuarit për punë të sigurt, me rastin e zëvendësimit të teknologjisë ekzistuese me teknologji të reja;
 6. Trainkos Sh.A. detyrohet të ndërmarrë masat e duhura për sigurinë dhe shëndetin në punë, duke siguruar udhëzime të përshtatshme për punë, për të punësuarit në vende të punës me rrezikshmëri të lartë dhe në këto vende të punës mund t'i angazhojë vetëm të punësuarit e trajnuar dhe të kualifikuar për ato vendet përkatëse.
-
-

Neni 7

Punëtori i ngarkuar për siguri dhe shëndet në punë

Trainkos Sh.A. duhet të angazhoi një (1) punëtor për kryerjen e detyrave nga siguria dhe shëndeti në punë.

Neni 8

Ndihma e parë, fikja e zjarreve, evakuimi i punëtorëve rreziqet serioze dhe të mundshme

1. Trainkos Sh.A. është i detyruar të ndërmarr masat e nevojshme për ndihmën e parë, fikjen e zjarrit dhe evakuimin e punëtorëve .
2. Trainkos Sh.A. është i detyruar të organizojë dhe ti ofroi ndihmën e parë punëtorëve në rast të lëndimit në punë ose sëmundjeve të papritura dhe të siguroi përcjelljen e tyre në trajtim mjekësor.
3. Trainkos Sh.A. trajnon punëtorët, që do të kryejnë evakuimin, shpëtimin, fikjen e zjarrit dhe dhënjen e ndihmës së parë.
4. Trainkos Sh.A. përmes punëtorëve të trajnuar, kryen evakuimin, shpëtimin, fikjen e zjarrit dhe dhënjen e ndihmës së parë për punëtorët e saj.
5. Trainkos Sh.A. harton një plan për evakuimin dhe shpëtimin në situata emergjente të cilin plan ia bënë të ditur të gjithë punëtorëve .
6. Trainkos Sh.A. është e detyruar të mbajë kontakte të nevojshme me shërbime të jashtme sidomos lidhur me ndihmën e parë, kujdesin emergjent mjekësor, shërbime shpëtimi dhe shërbimin e zjarrëfikseve.

Neni 9

Masat për mbrojtje nga zjarri

1. Trainkos Sh.A. janë të obliguara që të përmbushin kërkesat nga aspekti i sigurisë për mbrojtje kundër zjarrit sipas Ligjit për Mbrojtje nga Zjarri të Republikës së Kosovës.
 2. Trainkos Sh.A. janë të obliguara që të sigurojnë numër të mjaftueshëm të aparateve për fikjen e zjarrit dhe të jenë me mbushje adekuate sipas llojit të shkaktarit të zjarrit si dhe në përputhje me planin për mbrojtje nga zjarri.
 3. Trainkos Sh.A. janë të obliguara që këto pajisje t'i mbajnë në gjendje të rregullt dhe t'i rimbushin në afate të caktuara të cilat duhet të shënohen në etiketën e vendosur në aparat.
 4. Trainkos Sh.A. janë të obliguara që të instalojnë hidrantë në objekte punuese ku ka rrezik të shtuar për shpërthimin e zjarrit dhe ku konsiderohet që aparatet për fikjen e zjarrit nuk janë të mjaftueshme për fikjen e zjarrit.
-

Neni 10

Përdorimi i mjeteve të punës dhe pajisjeve mbrojtëse individuale gjatë procesit të punës

1. Trainkos Sh.A. janë të obliguara që mjetet e punës t'i mbajnë në gjendje të rregullt, të kontrollojnë rregullsinë dhe sigurinë e tyre me kontrolla të herëpashershme në afate të përcaktuara me aktin që e miraton, përkatësisht me udhëzimin e prodhuesit, dispozitat dhe standardet teknike.
2. Nëse me udhëzimin e prodhuesit nuk janë parashikuar afate të tjera, Trainkos SH.A. është e obliguar që mjetet e punës t'i kontrolloi, provoi dhe testoi.
3. Trainkos Sh.A. duhet të siguroi që mjetet e punës dhe pajisjet individuale mbrojtëse, të jenë në gjendje të mirë dhe të rregullt në çdo kohë dhe t'i përgjigjen standardeve teknike në përputhje me rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Neni 11

Objektet / ndërtesat

Për çdo objekt/ndërtesë, të destinuar për punë, Trainkos Sh.A. duhet të sigurojë:

1. Që secila ndërtesë apo objekt i destinuar për punë, t'i ketë daljet emergjente.
2. Planin për evakuim në mënyrë që punëtorët të evakohen nga objekti/ndërtesa, në rastin e ngjarjeve të papritura, prej të cilave rrezikohet jeta dhe shëndeti i punëtorëve.
3. Që rrugët dhe daljet emergjente të jenë të shënuara qartë me shenja adekuate, të cilat do të vendosen në vende të dukshme dhe në përputhje me rregullat.
4. Që rrugët dhe daljet emergjente të jenë të lira, pa pengesa dhe të cilat të dërgojnë direkt jashtë zonës së rrezikshme apo në një zonë të sigurt.
5. Hapësirën për dhënien e ndihmës së parë dhe pajisjet e nevojshme.
6. Hapësirën e nevojshme për pushim.
7. Hapësirat ndihmëse (dhoma për ushqim, dhoma e veshjeve/garderoba, banjo, tualetet ndaras për femra dhe meshkuj).

Neni 12

Për siguri të punëtorëve në punë përgjegjës janë: Bordi i Trainkos SH.A. Kryeshefi ekzekutiv, Drejtorët e Departamenteve, menaxherët e sektorëve në sektorë, shefat e njësisve nëpër njësi, udhëheqësit e punëve nëpër punëtori dhe punëtorët tjerë që janë të autorizuar për mbikëqyrje të punëve deri sa ato të kryhen (në tekstin vijues: udhëheqësit e punëve).

Neni 13

Drejtorët e Departamenteve janë të obliguar dhe përgjegjës për aplikimin dhe avancimin e masave për siguri ne departamente te konstatuara me ligj, me këtë Rregullore dhe dispozitave tjera të aplikueshme.

Drejtorët e Departamenteve janë të obliguar të japin vendime për mënjanimin e mangësive të konstatuara me kontrollin e organit mbikëqyrës, me kohë ti lajmërojnë Sektorin e resurseve njerëzore dhe te kujdesen për mënjanimin e mangësive të cilat kanë të bëjnë me tekniken e mjeteve te punës, stabilimenteve dhe objekteve.

Neni 14

Shefi i njësisë punuese, Menaxheri i sektorit dhe Drejtori i Departamentit janë përgjegjës për respektimin e rregulloreve dhe dispozitave mbi sigurinë në punë, posaçërisht janë të obliguar:

1. Që gjendja e sigurisë në punë në njësitë punuese të zbatohet në përputhje me dispozitat e caktuara dhe me të arriturat bashkëkohore shkencore dhe teknologjike;
 2. Që pa kushtëzime të respektohen dhe të zbatohen në realitet të gjitha dispozitat e kësaj rregullore, vendimet, konkluzionet dhe udhëzimet të cilat kanë të bëjnë me sigurinë në punë dhe avancimin e tyre;
 3. Që me rastin e ndryshimit të organizimit të punës, procesit teknologjik, ri konstruktive ose furnizimit me stabilimente të reja pune, organizohet njoftimi i punëtorëve për rreziqet dhe masat mbrojtëse në punë si dhe bëhet furnizimi me mjete adekuate mbrojtëse në punë;
 4. Që puna e punëtorit dhe detyrat për siguri në punë të zhvillohen pa pengesa dhe në harmoni me detyrat e parashtruara dhe me të gjitha elementet nga siguria në punë;
 5. Të parashtroni fletëparaqitje ndaj punëtorëve të cilët nuk u përmbahen rregulloreve dhe dispozitave për siguri në punë;
 6. Që menjëherë të urdhëroi ndërprerjen e punës posa të vërejë ose në çfarëdo mënyre njoftohet që direkt rrezikohet jeta e punëtorëve dhe për këtë menjëherë të njoftoi Zyrtarin për Siguri në Punë;
 7. Që të organizoi rregullisht dhënien e raporteve nga lëmia e sigurisë në punë;
 8. Të veproi sipas vendimit të organit mbikëqyrës e që në afatin e caktuar të eliminoi mangësitë e konstatuara, për çka e njofton Menaxherin e sektorit të resurseve njerëzore dhe Zyrtarin për Siguri në Punë të Trainkos SH.A.
 9. Është përgjegjës për kryerjen e kontrollave periodike, testimin fizik dhe kimik të rrezikshmërisë, testimin e pajisjeve për punë dhe udhëheqjen e evidencave të nevojshme;
 10. Është përgjegjës që punëtorët t'i caktoi sipas kualifikimit dhe aftësive të tyre shëndetësore.
-

Neni 15

Shifat e njësisë janë të obliguar që:

1. Të njoftohen me masat dhe rregulloret mbi sigurinë në punë;
 2. Punëtorët e sapo pranuar apo punëtorët e sistemuar në vend tjetër të punës para fillimit të punës duhet t'i njoftojnë me: organizimin e punës, me karakteristikat e mjeteve të punës dhe pajisjeve, me procesin teknologjik, sigurinë e qarkullimit të trenave dhe mjeteve lëvizëse, udhëzimet për punë, përdorimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve të punës, masat e sigurisë në punë dhe masat e sigurisë personale dhe të tjerëve gjatë punës dhe në vend të punës;
 3. Pa ndërprerë të bëjnë mbikëqyrjen, respektimin e rregulloreve dhe masat e sigurisë në punë në kuadër të njësisë dhe punishtes;
 4. Përkohësisht t'ia ndërprejnë punën, gjegjësisht detyrat e punës çdo punëtori i cili nuk i respekton rregulloret dhe masat e sigurisë në punë, që nuk shfrytëzon ose refuzon shfrytëzimin e pajisjeve personale mbrojtëse në punë ose refuzon të veproi sipas udhëzimeve për sigurinë në punë,
 5. Në rast të lëndimit t'i ofrojnë ndihmë të lënduarit,
 6. T'i plotësojnë dhe t'i dërgojnë fletëparaqitjet mbi lëndimin në punë në formularët e paraparë, më së voni 24 orë nga momenti që ka ndodhur lëndimi,
 7. Të bëjnë fletëparaqitje për lëndimin e obligimeve dhe detyrave ndaj punëtorit i cili nuk iu ka përmbajtur masave të parapara për mbrojtje në punë, e posaçërisht ndaj atyre që refuzojnë përdorimin e pajisjeve personale mbrojtëse,
 8. Me praninë e tyre dhe mbikëqyrjen të sigurojnë zhvillimin e sigurt të punëve, posaçërisht punëve të rrezikshme,
 9. Të angazhohen për gjendjen e rregullt të pajisjeve mbrojtëse dhe shfrytëzimin adekuat të tyre nga ana e punëtorëve, e në rast prishjeje angazhohen për rregullimin e tyre me kohë;
 10. Rregullisht të bëjnë shkollimin e punëtorëve në lëmin e sigurisë në punë dhe për këtë të udhëheqin evidencë të rregullt.
-

KREU III ORGANIZIMI I MBROJTJES NË PUNË

Neni 16

Trainkos Sh.A. organizimin e mbrojtjes në punë, organizimin operativ dhe ekzekutimin e punëve të sigurisë në punë e kryen përmes sektorëve dhe njësive punuese.

Neni 17

Zyrtari për Siguri në Punë në Trainkos Sh.A. me rastin e mbikëqyrjes së aplikimit të rregulloreve dhe masave të sigurisë në punë, nëse vëren se punëtorit i kërcënohet rreziku i drejtpërdrejtë për jetë dhe shëndet, ka të drejtë për marrjen e vendimit të ndërprerjes së procesit të punës dhe me vendimin e tij të njoftoi udhëheqësin e tij të drejtpërdrejtë dhe Menaxherin e sektorit në të cilin është evidentuar rreziku, Zyrtari për Siguri në Punë së bashku me raportin e inspektimit duhet të rekomandojë Menaxhmentin se si të veprohet me tutje në përmirësimin e sigurisë në atë vend të punës.

KREU IV TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E TË PUNËSUARIT

Neni 18

Të drejtat e të punësuarit

Punëtori ka të drejtë të refuzoi të punoi, nëse i kërcënohet rreziku i drejtpërdrejt për jetë apo për shëndet.

Punëtori ka të drejtë të parashtrori kërkesë ose ankesë me shkrim Zyrtarit për Siguri në Punë në Trainkos Sh.A. në rastet kur i cenohen të drejtat në aspektin e sigurisë në punë.

Neni 19

Obligimet e të punësuarit

Punëtori është i obliguar që t'u përmbahet dispozitave të kësaj rregulloreje dhe rregulloreve tjera lidhur me sigurinë në punë.

Neni 20

Punëtori është i obliguar që në mënyrë të drejt të përdorë veglat e punës. Me rastin e kryerjes së punës punëtorët janë të obliguar që të gjitha veglat e punës t'i vendosin në gjendje të rregullt dhe të paraparë e që në atë mënyrë tua bëjnë të mundur punëtorëve tjerë që veglat t'i përdorin pa pengesë dhe të vazhdojnë punën.

Neni 21

Shefat e njësive nëpër njësi, udhëheqësit e punëve nëpër punëtori dhe punëtorët tjerë që janë të autorizuar për mbikëqyrje të punëve, janë të obliguar që t'i njoftojnë punëtorët me kushtet e punës dhe rreziqet të cilat ekzistojnë në çdo vend të punës dhe masat për siguri në punë. Punëtorët nga paragrafi i parë i këtij neni, janë të obliguar të kenë kujdes t'i shfrytëzojnë pajisjet për siguri në punë.

Neni 22

Menaxheret e Sektorëve, shefat e njësive, zyrtarët për siguri dhe zyrtarët me përgjegjësi apo autorizime të posaçme janë të obliguar të iniciojnë procedurë disiplinore ndaj punëtorëve të cilët nuk i'u përmbahen dispozitave të kësaj rregulloreje dhe rregulloreve tjera mbi sigurinë në punë.

KREU V VLERËSIMI I RREZIKSHMËRISË

Neni 23

1. Trainkos Sh.A. është e detyruar të bëjë vlerësimin e rrezikshmërisë në vendet e punës, me qëllim të parandalimit të rrezikut, përfshirë dhe ekspozimin e punëtorëve nga elementet e dëmshme dhe të rrezikshme për shëndetin dhe sigurinë në punë gjatë procesit të punës.
 2. Trainkos Sh.A. vlerësimin e rrezikshmërisë në vendet e punës e bënë nga profesionist të fushave përkatëse.
 3. Trainkos Sh.A. është e detyruar të mbajë evidencë për lëndime në punë, sëmundjet profesionale dhe të pajisë të lënduarin me fletë lëndim në vend të punë.
-

Neni 24

Punët me kushte të veçanta

1. Punë me kushte të veçanta janë punët që mund të kryhen vetëm nga të punësuarit të cilët përveç kushteve të përgjithshme për themelimin e marrëdhënies së punës, duhet t'i përmbushin edhe kushtet dhe kriteret e veçanta të moshës, gjinisë, aftësisë profesionale, shëndetësore, fizike, gjendjes mendore dhe psiko-fizike.
2. Trainkos Sh.A. është e detyruar që para se të caktojë të punësuarin në vend të punës me kushte të veçanta, ta dërgoi atë në kontrollim mjekësor, që të konstatoi aftësitë e tij shëndetësore fizike dhe psikike, për kryerjen e punëve në atë vend të punës.

Neni 25

Në bazë të ndikimeve të dëmshme, që dalin nga kushtet e punës, në shëndetin e punëtorëve si punë me kushte të veçanta pune caktohen këto:

1. Udhëheqës trenash – Ndihmës makinist
2. Frenues-Manovrues
3. Makinist
4. Kontrolluesit e vagonëve

Neni 26

Trainkos Sh.A. është e detyruar t'i dërgoi punëtorët në kontrollim periodik mjekësor.

Evidentimi i kontrollimeve bëhet nëpër njësi punuese ku ato duhet të kryhen si dhe në Sektorin për Çështje Ligjore dhe Resurse Njerëzore në koordinim me sektorët dhe departamentet përkatëse.

Mënyra e dërgimit të punëtorëve në kontrollim mjekësor paraprak dhe periodik, numri dhe qasja e tyre janë të rregulluara me Rregullore mbi Kontrollimet Periodike Mjekësore në Trainkos Sh.A.

KREU VI
SHKOLLIMI, TRAJNIMI DHE VERIFIKIMI I DITURISË
Neni 27

Gjatë punës, punëtorët i nënshtrohen verifikimit të njohurive nga mbrojtja në punë :

1. Punëtori i nënshtrohet provimit profesional sipas Rregullores 646, i cili punon nën kushte të veçanta pune së paku tri herë brenda një viti.
2. Kur të fillon punën punëtori në Trainkos Sh.A.
3. Me sistemimin e punëtorit në tjetër vend pune, përkatësisht detyra të reja.
4. Me aplikimin e teknologjisë së re ose ndërrimit të teknologjisë.
5. Ndërrimi i kushteve të punës në sistemin e sigurisë në punë.

Neni 28

Nëse punëtori gjatë verifikimit të njohurive nga siguria në punë para komisionit nuk tregon njohuri të mjaftueshme, punëtorit përgjegjës duhet t'i ndalohej puna të cilën e ka kryer paraprakisht dhe duhet të sistemohet në ndonjë vend tjetër të punës që i përshtatet përgatitjes së tij profesionale.

Neni 29

Shkollimi i punëtorëve kryhet në bazë të plan-programit të shkollimit, shkollimi, arsimimi dhe plotësimi i njohurive të punëtorëve nga materia e sigurisë në punë. Shkollimin e kryen udhëheqësi i njësisë punuese përkatësisht personi i autorizuar në afatin e paraparë me rregullore, planit dhe programit të shkollimit. Pas mbarimit të pjesës teorike të shkollimit nga siguria në punë, kryhet pjesa praktike e shkollimit për profesionin që punëtori ka dhënë provimin. Pas kryerjes së programit të shkollimit, bëhet verifikimi i obligueshëm i njohurive dhe aftësive të punëtorit për punë të pavarur dhe të sigurt në punët dhe detyrat e punës të cilat i kryen.

Neni 30

Pas kryerjes së shkollimit teorik dhe praktik nga rregullat e sigurisë, punëtori është i obliguar të nënshkruajë deklaratën që është i njoftuar për masat dhe rregullat e sigurisë në punë. Deklarata nënshkruhet në dy kopje, ku njëra mbetet në njësinë organizative ndërsa tjetra në sektorin e Resurseve njerëzore në dokumentacionin e kuadrove.

Formulari i deklaratës vërtetohet me planin dhe programin e shkollimit të punëtorëve nga siguria në punë.

KREU VI
PAIJSJET PËSONALE MBROJTËSE
Neni 31

Punëtorët kanë të drejtë në pajisjet personale mbrojtëse gjatë kohës së punës.

Pajisjet personale mbrojtëse për çdo vend pune veç e veç, afati i tyre i qëndrueshmërisë, janë të rregulluara me Rregulloren mbi rrobat mbrojtëse dhe Rregulloren mbi Uniforma të Trainkos Sh.A. dhe janë pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.

Neni 32

Punëtori ka të drejtë dhe obligim që rregullisht dhe në mënyrë të paraparë për aplikim t'i shfrytëzoi pajisjet personale të sigurisë në punë, që me kujdes t'i përdorë ato dhe t'i mirëmban në gjendje të rregullt.

Neni 33

Në rastet e punëtorëve me kontratë për punë me afat të caktuar, ose punëtorë me detyra të posaçme, me këtë Rregullore nuk janë të rregulluara pajisjet personale mbrojtëse që ndërkohë punojnë punë që i'u nënshtrohen rreziqeve të ndryshme atmosferike ose ndikimeve tjera e që është e nevojshme të mbrohen gjatë punës, i'u sigurohen pajisje mbrojtëse personale të përkohshme derisa është e nevojshme.

Trainkos SH.A. është e obliguar të siguroi sasi të mjaftueshme të rrobave, mbathjeve dhe mjete tjera mbrojtëse, si rezervë inventari për përdorim të përkohshëm. Pajisjet mbrojtëse pasi që kryhen punimet e përkohshme punëtorët janë të obliguar t'i kthejnë në depo të pastra dhe në gjendje të rregullt.

Neni 34

Punëtori i cili ka qenë në pushim mjekësor ose ka munguar nga puna për shkaqe të ndryshme pa ndërprerë më tepër se një muaj ditë, afati i qëndrueshmërisë së pajisjeve personale të sigurisë dhe mjeteve tjera u vazhdohet për aq kohë sa punëtori ka munguar nga puna përveç me rastin e shfrytëzimit të pushimit vjetorë.

Neni 35

Nëse punëtori me pakujdesi i dëmton pajisjet personale të sigurisë, është i obliguar të bëjë kompensimin e dëmit në lartësi që cakton organi kompetent i Trainkos SH.A.

Nëse pajisjet për siguri personale humbin në vlerë të përdorimit para skadimit të afatit të qëndrueshmërisë në raste të mangësive të parashikueshme teknike ose të ngjarjeve të jashtëzakonshme, pajisjet e tilla duhet ndërruar. Vendimin për ndërrimin e pajisjeve personale mbrojtëse e sjell udhëheqësi i njësisë punuese, e me propozim të komisionit profesional të

sektorit, përkatësisht ose njësia punuese të cilat e përbëjnë sektorin, Menaxheri i sektorit ose Drejtori i Divizionit.

Neni 36

Pajisjet e parapara për siguri personale për punë të caktuara pa afat të qëndrueshmërisë, shfrytëzohen si gjëra të inventarit deri në dalje jashtë përdorimit.

Neni 37

Shërbimi i cili bën furnizimin me pajisje për siguri personale paraprakisht duhet të marr mendimin nga zyrtari për siguri në punë, mbi përshtatshmërinë dhe cilësinë e pajisjeve personale për siguri në punë.

Neni 38

Pas kryerjes së punëve ditore, ku për atë ekzistojnë kushtet, punëtorët i vendosin pajisjet e tyre personale në vendet ku është i caktuar për to. Pas punës, është e ndaluar të përdoren rrobat mbrojtëse, këpucët dhe pajisjet tjera për siguri personale.

Neni 39

Punëtorëve i'u takojnë rrobat mbrojtëse nga dita e fillimit në punën e caktuar. Afatet e qëndrueshmërisë së pajisjeve personale mbrojtëse fillojnë nga dita e fitimit të së drejtës, përkatësisht skadimit të afatit paraprak.

Neni 40

Punëtori i cili posedon mjetet personale mbrojtëse të cilit i'u kanë ndarë sipas rregulloreve paraprake të deri tanishme, mjetet e reja mbrojtëse i ndahen në ditën kur iu kalon afati i qëndrueshmërisë mjeteve personale të përdorura.

Neni 41

Në rast lëndimi të rëndë ose vdekje në vendin e punës, punëtori përkatësisht familja e tij, nuk janë të obliguar t'i kthejnë pajisjet personale mbrojtëse edhe nëse afati i vlefshmërisë nuk i'u ka kaluar. Punëtori, kur shkon në pension i mbanë rrobat dhe mbathjet mbrojtëse pa kompensim.

KREU VII
PROCEDURA DHE VEPRIMI I TESTIMIT TË VEGLAVE PËR PUNË
Neni 42

Me vegla të punës nënkuptojmë:

1. Veglat e dorës dhe veglat e mekanizuara të dorës;
2. Mjetet e mekanizuara për punë;
3. Pajisjet dhe stabilimentet me të cilat kryhen punët në Trainkos Sh.A.

Neni 43

Veglat e punës mund ti përdorin vetëm ata punëtorë që janë të kualifikuar për to dhe janë të ngarkuar me to. Punëtorët mund të punojnë vetëm me vegla të cilat janë në gjendje të rregullt për punë.

Neni 44

Punëtori është i obliguar që para fillimit të punës, të verifikoj se veglat me të cilat duhet të punoi a janë në gjendje të rregullt për punë. Në rast se vegla për punë nuk është në gjendje të rregullt, punëtori është i obliguar që menjëherë ta njoftoj udhëheqësin e drejtpërdrejt.

Neni 45

Kontrollimi periodik i gjendjes së veglave për punë për të cilat Trainkos Sh.A. nuk është e autorizuar ti kryej, i kryen kompania e autorizuar për siguri në punë, në periudhat e caktuara sipas dispozitave të rregulloreve për siguri në punë, dhe për këtë është e obliguar të lëshoj dokumentet përkatëse.

Neni 46

Veglat për punë me të cilat furnizohen, të ri-konstruara ose të zhvendosura mund të lëshohen në punë vetëm atëherë kur të kryhet kontrolli mbi aplikimin e masave mbrojtëse në punë dhe lejes për përdorim të cilën e jep grupi i ekspertëve të veprimtarive përkatëse dhe zyrtari për siguri në punë.

KREU VIII
OBLIGIMET E ORGANIT MBIKQYRËS DHE UDHËHEQJA E EVIDENCAVE
Neni 47

Trainkos Sh.A. është e obliguar që menjëherë ta lajmëron Inspektoratin e Punës në rast vdekjes se punëtorit në vendin e punës, lëndime individuale/kolektive të rënda në punë dhe dukuritë të cilat do të mund të rrezikonin sigurinë në punë.

Neni 48

Trainkos Sh.A. është e obliguar të ja mundësoj Inspektoratit të Punës që të ketë qasje në kompani në çdo kohë në kohën e punës dhe të ja mundësojë kontrollimin e punishteve, hapësirave dhe stabilimenteve, qasje në dokumente, gjegjësisht të dhënave të nevojshme për kryerjen e mbikëqyrjes mbi aplikimin e akteve normative mbi sigurinë në punë. Kontrollit detyrimisht i asiston edhe udhëheqësi i njësisë punuese dhe punëtori përgjegjës për siguri në punë.

Neni 49

Trainkos Sh.A. është e detyruar që me kërkesë të inspektorit të punës t'i paraqes të dhënat e nevojshme në lidhje me siguri në punë dhe t'ia mundësoi që punëtorët t'i japin informata të nevojshme.

Neni 50

Trainkos Sh.A. është e detyruar të veproi sipas vendimit të Inspektoratit të Punës dhe në afatin e caktuar të bëjë eliminimin e mangësive të konstatuara.

Neni 51

Punëtori përgjegjës i Trainkos Sh.A. për siguri në punë, është i obliguar që menjëherë ose më së voni 24 orë pas ndodhjes së lëndimit ose nga momenti i lajmërimit të mundësisë e cila do të mundë të rrezikoi sigurinë e punëtorëve, të lajmëroi organet kompetente si dhe sektorin për Çështje Ligjore dhe Resurse njerëzore.

Lajmërimi duhet të përmbajë:

Mbiemrin, emrin e babës dhe emri i personit të lënduar, dita dhe vendi i lindjes, profesioni, kualifikimi, cilat punë i kryen, emri i njësisë punuese dhe selinë, dita, ora dhe vendi ku është lënduar, cilat punë i ka kryer në momentin e lëndimit, përshkrimin e lëndimit, burimet, shkaqet e

lëndimit, lloji i lëndimit, lëndimi i pjesës trupore me theks se a është fjala për të vdekur, lëndimeve kolektive apo të rënda, dhe kush ju ka ofruar ndihmën e parë dhe a është vendosur personi në institucion shëndetësorë dhe në cilin.

Nëse është fjala për dukuri e cila do të mundë të rrezikoj sigurinë e punëtorëve në raport duhet të ceket: data, ora dhe vendi i dukurisë së tillë, përshkrimi i shkurtë i dukurisë, shkaqet e dukurisë, pasojat, mënyra nga e cila ka mundur të vijë deri te rrezikimi i sigurisë së punëtorëve dhe cilat masa janë ndërmarr.

Neni 52

Me këtë rregullore vërtetohen obligimet e udhëheqjes së evidencave vijuese në lëmin e sigurisë në punë :

1. Evidencat mbi lëndimet në punë, vdekjeve, lëndimeve të rënda dhe kolektive.
2. Evidencat e kontrollimeve periodike mjekësore për punëtorët në punë dhe detyra e punëve me kushte të veçanta pune.
3. Evidencat e sëmundjeve profesionale.
4. Evidencën e testimiit dhe kontrollimit periodik të veglave dhe pajisjeve të punës.
5. Evidencat e testeve kimike, matjeve mikro-klimatike, zhurmës dhe ndjeshmërisë së vibracioneve.
6. Evidencën e trajnimit dhe arsimimit të punëtorëve.
7. Evidencimin e dukurive që mund të rrezikojnë sigurinë e punës.
8. Evidencën e konstatimeve të mangësive dhe parregullsive të organeve të inspektorateve dhe afatin e ekzekutimit.
9. Evidenca e objekteve për ujë dhe testimiit të ujit të pijshëm.
10. Evidencat nga alineja një, dy, katër, pesë, tetë dhe nëntë, mbahen në sektorin e resurset njerëzore, në sektorë dhe njësi punuese, ndërsa evidencat tjera udhëhiqen në sektorë dhe njësi punuese.

Neni 53

Zyrtari përgjegjës për sigurinë punë, për çdo lëndim të rënd, lëndimeve kolektive dhe vdekjeve lajmëron inspektoratin kompetent për siguri në punë dhe sektorin e resurseve njerëzore në Trainkos Sh.A. kryen inspektimin e lëndimit në vendin e ngjarjes dhe për këtë përpilon procesin me skicë të vendit të ngjarjes ku edhe paraqet elaboratin komplet inspektoratit kompetent të punës në sektorin e resurseve njerëzore. Përmbajtja e elaboratit është si në vijim:

1. Fletëparaqitja mbi lëndimin në punë.
 2. Deklaratat e dëshmitarëve.
 3. Deklarata e të lënduarit.
 4. Deklarata e udhëheqësit të drejtpërdrejt.
 5. Skicën e ngjarjes.
-

6. Kontratën mbi sistematizimin e punëtorit
7. Raportin nga sistematizimi i vendit të punës dhe detyrave të punës për punëtorin e lënduar.
8. Raportin e fundit mbi kryerjen e kontrollimit mjekësorë.
9. Certifikatën e dhënies së provimit.
10. Raportin mbi njoftimin për masat e mbrojtjes në punë.

Neni 54

Në çdo sektor – njësi organizative punuese udhëhiqet libri i unifikuar i lëndimeve në punë ku evidentohen çdo ndodhje e lëndimeve në punë.

KREU IX DHËNIA E NDIHMËS SË PARË

Neni 55

Trainkos Sh.A. në çdo vend zyrtarë dhe ambient të punës siguron pajisje për dhënien e ndihmës së parë. Në përbërje të pajisjeve gjenden materialet e parapara sipas standardeve dhe udhëzimeve të aplikuara.

Neni 56

Pajisjet e ndihmës së parë duhet të jenë të vendosura në kutitë të cilat vendosen në vende ku qasja duhet të jetë e lehtë, dhe në pjesën e jashtme të kenë shenjën e “kryqit të kuq”.

Në kuti duhet të jenë të shënuara :

1. Adresa dhe numri i telefonit të institucionit më të afërt shëndetësor,
2. Për disa turne pune : emrat e punëtorëve të aftësuar, dhe të caktuar për ofrimin e ndihmës së parë.

Neni 57

Kutia e ndihmës së parë duhet të jenë e mbyllur. Çelësi i kutisë gjendet te punëtori i cili është i aftësuar dhe i caktuar për ofrimin e ndihmës së parë.

Neni 58

Zyrtari për siguri në punë bënë mbikëqyrjen për materialin, pajisjet dhe aftësimin e punëtorëve për ofrimin e ndihmës së parë.

Neni 59

Në rast të ndodhjes së fatkeqësive elementare, eksplodimeve, zjarrit ose fatkeqësive masive (ngjarje të jashtëzakonshme) Kompania është e obliguar të organizoi masa për evakuimin dhe shpëtimin e punëtorëve.

KREU X

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Neni 60

Trainkos Sh.A. obligohen që të sigurojnë kushtet dhe masat e nevojshme të parapara me këtë Rregullore, ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje bëhen në harmoni me aktet normative të Trainkos Sh.A. dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 61

Kjo rregullore hynë në fuqi pas aprovimit nga Bordi i Drejtorëve dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve i Hekurudhave të Kosovës-Trainkos Sh.A. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja e mëparshme.


Heset Cakolli
Kryesues i Bordit të HK-Trainkos Sh.A.
